



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 59
Prishtinë, më 1.4.2019, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Driton Çausi, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu dhe Verica Çeraniç.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të GIZ/CDBE, KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.3.2019 dhe 15.3.2019;**
- 3. Diskutim lidhur me planin e veprimit për monitorimin e zbatimit të ligjeve;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.3.2019 dhe 15.3.2019

Me propozim të kryetarit të Komisionit, miratimi i procesverbaleve shtyhet për në mbledhjen e radhës.

3. Diskutim lidhur me planin e veprimit për monitorimin e zbatimit të ligjeve

Ismajl Kurteshi tha se grupet punuese të formuara për monitorimin e Ligjeve duhet të intensifikojnë punët e tyre në përgatitjen e planit të veprimit për monitorim dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara. Ai njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me gatishmërinë e GIZ për të mbështetur me ekspert punën e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

Teuta Haxhiu tha se si kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Arsimit nga java e ardhshme mund të fillojmë me aktivitetet mbikëqyrëse duke realizuar vizita në zyrat rajonale të Inspektoratit të Arsimit, gjegjësisht vizitën e parë tha se planifikon ta realizojë në Komunitet e Pejës dhe të Gjakovës.

Luljeta Veselaj-Gutaj, në diskutimin e saj si kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar, kërkoi nga anëtarët e grupit punues të japin kontributin e tyre në përgatitjen e planit të veprimit, si dhe propozimin e aktiviteteve që ndërlihen me vizitat në terren. Propozoi që në planin e veprimit të përfshihen DKA-të e të gjitha qendrave rajonale dhe institucione arsimore publike dhe private. Njëkohësisht propozoi që vizitat në terren të koordinohen bashkërisht me grupin punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin me qëllim të racionalizimit të kohës.

Mufeta Shinik, propozoi që në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për Arsimin Parauniversitar të vizitohet institucioni arsimor privat Maarif në Prizren.

Driton Çausi tha se pajtohet me propozimin që të bëhet koordinimi i dy grupeve punues gjatë vizitave në terren.

Ismajl Kurteshi propozoi që ditën e premte, më 5 prill 2019, dy grupet punuese të realizojnë vizitë në MASHT dhe të takohen me përfaqësues të Departamentit të Inspektoratit të Arsimit dhe Departamentit të Arsimit Parauniversitar.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi ngriti çështjet e vizitës së Komisionit në Luginë të Preshevës dhe propozoi që kjo vizitë të realizohet pas datës 15 prill, përgatitjet për vizitën e Komisionit homolog nga Kuvendi i Shqipërisë në fillim të muajit maj, si dhe organizimin një vizite të Komisionit në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

Teuta Haxhiu tha se si deputete në legjislaturën e kaluar ka marrë pjesë në vizitën e Komisionit në Luginë të Preshevës dhe pas kësaj vizite kemi premtuar tekste shkollore për nxënësit e Luginës, ndërsa nuk janë realizuar. Tha që është mirë të kërkohet nga MASHT se çfarë është ndërmarrë lidhur me dërgimin e teksteve shkollore për nxënësit e Luginë së Preshevës dhe a ekziston ndonjë marrëveshje ndërmjet MASHT dhe Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë lidhur me këtë çështje.

Luljete Veselaj-Gutaj tha se paraprakisht duhet shikuar mundësitë se çfarë mund të bëjmë konkretisht për Luginën e Preshevës dhe të mos shkojmë vetëm për të biseduar dhe me i dëgjuar kërkesat e tyre.

Albulena Balaj-Halimaj, propozoi që çështja e vizitës së Komisionit në Luginë të Preshevës të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

Ismajl Kurteshi tha se vizita në Luginë të Preshevës, ndër të tjera, duhet realizuar për arsye të përkrahjes morale, për t'u njoftuar me kërkesat e tyre, si dhe problemet që ballafaqohen qytetarët e Luginës me i ngritur në Kuvend dhe me i bërë publike në media.

Driton Çausi ngriti çështjen e sjelljes së papërgjegjshme të SBASHK-ut, lidhur me mos kompensimin e orëve të humbura nga greva në arsim. Me këtë rast propozoi që komisionit edhe një herë t'i ftojë në një takim të përbashkët përfaqësues të MASHT-it, SBASHK-ut dhe Këshillit të Prindërve me qëllim të gjetjes së një zgjidhje për kompensimin e orëve të humbura.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e komisionit dhe u caktua që takimi të mbahet ditën e mërkurë, më datë 3 prill 2019, duke filluar në orën 10:00, pa praninë e mediave.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi